

1 E martë, 30 mars 2021

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit nuk janë të pranishëm]

5 --- Fillon në orën 15.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve në sallën
7 e gjyqit dhe jashtë saj.

8 Zonja Sekretare, mund të paraqisni çështjen.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kjo
10 është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe
11 Nasim Haradinajt.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Tani u kërkoj palëve ju lutem prezantohuni, duke filluar me
14 Prokurorin e Specializuar.

15 Z. PACE: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës, dhe të
16 gjithë të tjerëve në sallën e gjyqit dhe jashtë. Nga ana e
17 Prokurorisë janë paraqitur Alex Whiting, Zëvendësprokuror i
18 Specializuar; Valeria Bolici, prokurore; Matt Halling, prokuror i
19 asociuar; Line Pedersen, administratore e Çështjes dhe e Provave;
20 edhe unë jam James Pace, prokuror i asociuar.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mbrojtja, ju lutem.

22 Z. Rees, nuk keni mikrofon.

23 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar z.
24 Gjykatës, unë jam z. Rees. Paraqitem këtu në emër të z. Hysni
25 Gucati së bashku me Huw Bowden.

26 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë jam Toby
2 Cadman, dhe së bashku me Carl Buckley [sipas përkthimit]
3 përfaqësoj z. Nasim Haradinaj.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Përpara se të filloj me rendin
5 e ditës sot, dua t'i kujtoj palët se në qoftë se do të kenë ndonjë
6 problem me lidhjen me video, ju lutem njoftojeni ose Sekretaren e
7 Gjykatës ose mua duke na bërë shenjë me dorë. Në qoftë se do të
8 ketë probleme me lidhjen nga distanca, do të bëjmë përpjekje për
9 ta rivendosur lidhjen dhe në qoftë se nuk zgjidhet problemi
10 menjëherë, do të duhet të bëjmë një pushim për pak minuta në
11 mënyrë që të rivendosim lidhjen.

12 Tani të kaloj te historia procedurale e çështjes.

13 Më 23 mars unë caktova datën e Konferencën për Ecurinë e
14 Çështjes për sot, dhe synimi im ishte që të shikonim se ku jemi me
15 ecurinë e çështjes dhe të organizojmë shkëmbimet me palët në
16 lidhje që -- në mënyrë që të bëjmë përgatitjet e duhura për
17 gjykimin. Sidomos, desha të fokusohem te nxjerrja e materialeve
18 dhe gjendja e hetimeve të Mbrojtjes.

19 I falënderoj Prokurorinë dhe Mbrojtjen për parashtrimet me
20 shkrim që kanë dorëzuar. Nuk ka nevojë që të përsërisin
21 parashtrimet e tyre në hollësi, por dëshiroj që të dyja palët të
22 flasin për çështjet e tyre duke ndjekur pikat e rendit të ditës.

23 Si edhe herë të tjera, dua t'ju kujtoj se në qoftë se do t'ju
24 duhet të zbuloni material apo informacion konfidencial duhet të na
25 njoftoni që të hyjmë në seancë të mbyllur.

26 Tani të kaloj në lidhje -- të diskutoj në lidhje pikën e

1 interesave materiale. Dua t'i kujtoj palët se janë disa kërkesa që
2 ende nuk janë trajtuar në lidhje me nxjerrjen e materialeve:

3 Së pari, parashtrimet e Prokurorisë në lidhje me rëndësinë
4 materiale të disa informacioneve që ka kërkuar Mbrojtja në bazë të
5 rregullës 102(3); ky është parashtrimi F149.

6 Së dyti, kërkesa e Prokurorisë për mosnxjerrjen e disa
7 informacioneve që ka kërkuar Mbrojtja në bazë të rregullës 102(3);
8 ky është dokumenti me numër F154.

9 Dhe së fundi, kërkesa e Prokurorisë për autorizimin e
10 redaktimeve jostandarde; është materiali me numër F155.

11 Vë re që Mbrojtja nuk i është përgjigjur këtij parashtrimi,
12 dhe informoj palët që do të lëshoj një urdhër në lidhje me këtë në
13 fund të Konferencës për Ecurinë e Çështjes sot.

14 Në urdhrin për caktimin e datës për Konferencën për Ecurinë e
15 Çështjes, unë i kërkoja Prokurorisë që të bënte parashtrime për të
16 gjitha pikat që ka kërkuar Mbrojtja në bazë të rregullës 102(3)
17 përpara konferencës së kaluar. Vë re se në parashtrimin e z.

18 Gucati ishte bërë kërkesë që të gjitha këto materiale që do të
19 dorëzohen të vihen në një listë në bazë -- në njoftimin në bazë të
20 rregullës 102(3). Ata rezervojnë të drejtën që të kërkojnë qasje
21 në këto materiale mbasi ta kenë marrë njoftimin.

22 Sidoqoftë, në urdhrin tim unë i kërkoja Prokurorisë nëse këto
23 materiale i janë dhënë Mbrojtjes, i janë dorëzuar Mbrojtjes, dhe
24 në qoftë se nuk i janë dorëzuar, atëherë a janë të disponueshme
25 dhe janë të nxjerrshme ato.

26 Së pari, dua të dëgjoj palët të më thonë -- të më flasin për

1 këto çështje, së pari, për konsideratat mbi bazat e të cilave u
2 hartua njoftimi sipas rregullës 102(3), duke pasur parasysh që në
3 bazë të nenit 21(6) dhe rregullës 102(3) Prokuroria duhet të japë
4 një njoftim të hollësishëm të të gjitha materialeve dhe provave që
5 janë relevante që ka në zotërimin e saj; dallimi midis këtyre
6 konsideratave dhe kriterit të rëndësisë materiale; diskutimet
7 *inter parte* që kanë ndodhur midis Mbrojtjes që nga koha e
8 Konferencës së fundit për Ecurinë e Çështjes; lista që është dhënë
9 në aneksin e parashtrimeve për këtë Konferencë të Ecurisë së
10 Çështjes; dhe në lidhje me listën dhe duke pasur parasysh
11 materialet shtesë të thotë Prokuroria nëse i ka përfshirë
12 materialet që ka kërkuar Mbrojtja në listën e saj, dhe në qoftë se
13 jo, pse jo; dhe së fundi, ndikimi që do të kenë kërkesat që i janë
14 bërë palëve të treta te procesi i nxjerrjes dhe në afatet kohore
15 për dorëzimin e dosjes paraprake.

16 Po kështu dua të dëgjoj nga palët në lidhje me vështirësitë
17 që mund të kenë në lidhje me procesin e nxjerrjes së materialeve.

18 Z. Prokuror, keni fjalën.

19 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

20 Do të përpiqem t'i përgjigjem të gjitha pyetjeve, po ju lutem
21 më kujtoni nëse harroj diçka.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do t'ju kujtoj.

23 Z. PACE: [Përkthim] Do të filloj duke parashtruar ato që ka
24 thënë Prokuroria dhe më parë në qasjen e saj në lidhje me
25 rregullën 102(3).

26 I referohem në veçanti materialit ose parashtrimin që kemi

1 bërë të premtën e kaluar, më 26 mars. Dhe siç e kemi thënë aty, në
2 bazë të nenit 21(6) dhe rregullës 102(3) Prokuroria ka detyrimin
3 që t'i japë njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për të gjitha
4 materialet apo provat që ka në dorëzim ose në zotërim, dhe që mund
5 të konsiderohen se janë pro ose kundër të akuzuarit.

6 Dhe ne e kuptojmë që sigurisht Mbrojtja do të kërkojë që të
7 gjithë materialet që i kanë shqyrtuar paraprakisht të futen në
8 listë. Ne nuk e kuptojmë kështu se çfarë thotë ligji dhe Vendimi
9 Kornizë. Ne e kuptojmë që duhet të bëhet një vlerësim i gjerë me
10 vullnet të mirë dhe të bëhet një njoftim në bazë të rregullës
11 102(3) që përmban të gjitha faktet që janë drejtpërsëdrejti të
12 lidhura me çështjen.

13 Po kështu, siç kemi thënë më përpara, ne do të bëjmë
14 parashtrime në bazë të rregullës 102(B) dhe 102(3), dhe ne e kemi
15 rishqyrtuar materialin dhe e kemi parë se çfarë duhet të dorëzojmë
16 sipas rregullës 102(3) dhe në bazë të rregullës 103.

17 Mbrojtja ka ngritur çështjen se dokumentet që janë dorëzuar
18 në bazë të rregullës 102(3) janë të kufizuara dhe ato që ne ju
19 kemi paraqitur juve, i nderuar Gjykatës, përsëri janë të
20 kufizuara. Këto janë voluminoze dhe sigurisht materialet që kanë
21 mbetur pa u dorëzuar deri tani janë të kufizuara, nuk janë shumë.

22 Në lidhje me listën, siç e kemi përcaktuar në përgjigjen
23 tonë, Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk ka detyrimin që të
24 japë njoftim të hollësishëm për materialet që nuk janë relevante
25 për Mbrojtjen, prandaj mendoj që kjo është një çështje për të
26 cilën ne si Prokurori dhe Mbrojtja kemi pikëpamje të ndryshme. Ne

1 mendojmë që e kemi bazuar parashtrimin tonë mbi bazën e rregullave
2 dhe në ligjin për Dhomat e Specializuara si dhe në Vendimin
3 Kornizë.

4 Për sa i përket disa çështjeve të tjera që i ngritët ju, i
5 nderuar Gjykatës, në lidhje me nxjerrjen e materialeve për
6 Mbrojtjen, kur ne iu përgjigjëm kërkesës së Mbrojtjes ne përfshimë
7 edhe atë që mendonim se duhej përfshirë në këtë njoftim. Ato
8 materiale që kemi dorëzuar nuk ishin në njoftimin 102 -- sipas
9 rregullës 102(3) dhe ne do të shohim se kur do t'i dorëzojmë këto
10 materiale. Arsyeja pse kërkojmë nga ju i nderuar Gjykatës të
11 vendosni këtë është se ne mendojmë që ne i kemi plotësuar kërkesat
12 dhe detyrimet tona sipas ligjit, përndryshe nuk e kuptojmë se
13 çfarë tjetër përfshihet në të dhe nuk na lejohet ajo -- nuk na bën
14 të mundur kërkesa e Mbrojtjes të kuptojmë se çfarë përfshihet dhe
15 çfarë nuk përfshihet në detyrimet tona.

16 Prandaj edhe ne kërkojmë nga ju i nderuar Gjykatës që për sa
17 i përket rëndësisë materiale, siç e kemi thënë në parashtrimet
18 tona, nuk është e mundur të bëhet sepse nuk mund të formulohet
19 kërkesa në terma kaq të gjera sa që e ka bërë Mbrojtja, për
20 shembull, duke thënë që "të gjitha materialet" janë me rëndësi
21 thelbësore për Mbrojtjen.

22 Nuk e di nëse keni diçka tjetër në lidhje me nxjerrjen në
23 këtë fazë, apo përndryshe mund të vazhdoj.

24 Për sa i përket kërkesave ndaj palëve të tjera, në
25 parashtrimet tona në konferencat e kaluara kemi thënë që kemi bërë
26 dy kërkesa të tilla dhe kemi marrë përgjigje për një kërkesë që i

1 është bërë palës së tretë më 18 mars. Ende nuk kemi marrë
2 përgjigje nga një palë e tretë tjetër dhe po bëjmë ç'është e
3 mundur që ta marrim këtë informacion përpara 9 prillit, siç është
4 përcaktuar në kalendar, por duke pasur parasysh që kjo është një
5 palë e tretë, ne varemi nga pala e tretë, dhe do t'ju informojmë i
6 nderuar Gjykatës nëse ka nevojë të bëhen parashtrime të tjera,
7 nëse duhen bërë hapa të tjerë në lidhje me këtë.

8 Dhe kaq kam tani për tani në lidhje me pyetjet tuaja i
9 nderuar Gjykatës.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Një pyetje para se t'ia jap
11 fjalën Mbrojtjes.

12 Disa nga materialet që u dhanë paraprakisht, për to nuk pati
13 kundërshtime në lidhje me rëndësinë materiale por ato nuk ishin
14 përfshirë në listën e parë, me njoftimin e hollësishëm në listën e
15 parë të tij sepse ato më vonë i keni dërguar.

16 Z. PACE: [Përkthim] Po. Kur ne i nxorëm këto materiale
17 Mbrojtjes nuk dhamë kushtin që nxjerrja e këtyre materialeve ka të
18 bëjë me rëndësinë thelbësore të tyre për mbrojtje. Nën drejtimin
19 tuaj i nderuar Gjykatës, kur Mbrojtja ka kërkuar që këto materiale
20 që do të dorëzoheshin duhet të ishin të arsyeshme, ne menduam që
21 ato, detyrimet tona, i kemi plotësuar në mënyrë të arsyeshme. Ne
22 jemi të gatshëm të bashkëpunojmë brenda kufijve të arsyes, por unë
23 nuk do të hyj në shumë elementë një për një. Sepse për shembull,
24 Mbrojtja ka bërë kërkesë për 27 materiale dhe ne nuk e kemi
25 menduar që ky informacion ishte i vlefshëm për Mbrojtjen sepse nuk
26 kemi me çfarë ta krahasojmë atë në bazë të kërkesës. Dhe

1 megjithëse ne i kemi dhënë disa urdhra apo kërkesa Mbrojtjes, këtë
2 e bëmë jo sepse këto kërkoreshin sipas detyrimeve tona për të
3 nxjerrë materialet, por ne e kuptuam që Mbrojtja bëri kërkesë për
4 to në mënyrë që të kishin njëlloj konfirmimi se ato ekzistonin apo
5 jo, dhe disa informacione u dhanë dhe disa jo. Dhe ne menduam,
6 okei, ata i kanë kërkuar këto materiale dhe i duhen, kështu që ua
7 dhamë. Dhe kjo ishte arsyeja kryesore për këtë pse janë dhënë --
8 pse janë nxjerrë këto materiale më vonë.

9 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani i kthehem Mbrojtjes, z.
11 Rees.

12 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mbrojtja --
13 Prokuroria thotë që nuk e kupton se çfarë po iu kërkon Mbrojtja
14 atyre. Ajo që kërkon Mbrojtja është shumë e qartë dhe është
15 pikërisht ajo që keni urdhëruar ju, i nderuar Gjykatës, më
16 përpara.

17 Vendimi Kornizë i juaji në paragrafët 46 dhe 48 ka kërkuar
18 nga Prokuroria që të bëjë një nxjerrje të plotë dhe të bëjë një
19 njoftim të hollësishëm mbi bazën e rregullës 102(3), pa vonesë.

20 Dhe rregulla 102(3) duhet -- thotë që në këtë njoftim duhet
21 të përfshihet çdo informacion i mbetur që është me rëndësi
22 potenciale materiale për Mbrojtjen dhe që mund të ketë materiale
23 fajësuese ose shfajësuese dhe duhet t'i referoheshin të gjitha
24 materialeve, sendeve të prekshme, e të tjerave që janë me rëndësi
25 thelbësore juridike për Mbrojtjen.

26 Ju, i nderuar Gjykatës, thoni në Vendimin Kornizë që

1 përgatitja e Mbrojtjes është një koncept i gjerë dhe nuk duhet të
2 lidhet drejtpërsëdrejti me provat -- vetëm me provat shfajësuese
3 apo fajësuese por -- apo vetëm me çështjen e Prokurorisë.

4 Dhe në formulimin që keni bërë ju në Vendimin Kornizë, i
5 nderuar Gjykatës, informacioni i mbetur që ka rëndësi materiale
6 për Mbrojtjen duhet të interpretohet edhe më gjerësisht në
7 formulimin që ai është me rëndësi, ai material, për përgatitjen e
8 Mbrojtjes.

9 Ju keni thënë i nderuar Gjykatës që Mbrojtja i ka dhënë
10 Mbrojtjes -- Prokuroria i ka dhënë Mbrojtjes materiale që nuk
11 ishin përfshirë në njoftimin sipas rregullës 102(3).

12 Ne kërkojmë një listë me një njoftim të hollësishëm që
13 përmban të gjitha materialet që i duhen Mbrojtjes pa vonesë.
14 Prokuroria, me sa shoh unë, nuk e kupton ose nuk e pranojnë dhe
15 nuk duan ta pranojnë se ju keni dhënë një vendim të qartë me një
16 fushëveprim shumë të gjerë si për njoftimin e hollësishëm ashtu
17 edhe për listën që kërkohet në bazë të rregullës 102(3).

18 Ne i kemi parashtruar mendimet tona në lidhje me
19 fushëveprimin e rregullës 102(3) dhe njoftimet që përmenden aty.
20 Dhe në lidhje me parashtrimet për këtë Konferencë të Ecurisë së
21 Çështjes që ju do t'i gjeni në paragrafin 5 deri në paragrafin 15,
22 ne kemi bërë parashtrime të hollësishme edhe në lidhje me
23 fushëveprimin e rregullës 102(3). Po kështu kemi bërë edhe një
24 parashtrim me numër F00157 që është një parashtrim konfidencial.

25 Aty ka edhe parashtrime edhe argumente të tjera të cilat kanë
26 për qëllim ta ndihmojnë Prokurorinë në interpretimin e gamës së

1 gjerë dhe fushëveprimit të gjerë që duhet të ketë njoftimi në bazë
2 të rregullës 102(3).

3 Unë -- a mund t'i përmend, t'i them edhe njëherë se çfarë kam
4 parashtruar aty?

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo, nuk ka nevojë, i kam marrë
6 parashtrimet me shkrim.

7 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Atëherë, nuk e di a
8 mund t'ju ndihmoj më tej.

9 Disa -- mendoj që Prokuroria duhet të pranojë se ka një
10 dallim midis njoftimit në bazë të rregullës 102(3) dhe
11 fushëveprimit të gjerë të këtij njoftimi siç e keni përcaktuar ju,
12 i nderuar Gjykatës. Pra, është një njoftim që duhet të përmbajë të
13 gjitha hollësitë që janë me rëndësi materiale dhe të gjitha provat
14 që ka në zotërim ZPS-ja, dhe dallimi me fazën e dytë që del jashtë
15 rregullës 102(3) që është mënyra sesi do të trajtohen kërkesat nga
16 Mbrojtja.

17 Kriteri i rëndësisë materiale që kërkon të zbatohet Prokuroria
18 në njoftimin e vet lidhen me fazën e dytë, pra, me kërkesën e
19 Mbrojtjes për të parë materiale, për t'i këqyrur ato, për të bërë
20 kopje apo për të pasur lista të këtyre -- për të pasur këto
21 materiale që janë të vendosura në listë. Pra, Prokuroria duhet ta
22 bëjë këtë dallim midis së parës dhe së dytës dhe të zbatohet
23 urdhrin që keni dhënë ju.

24 Nuk e di a mund t'ju ndihmoj më tej i nderuar Gjykatës.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees. Mund
26 t'ju jap fjalën pak më vonë.

1 Por do doja që t'i kërkoja Mbrojtjes tjetër në qoftë se ka
2 ndonjë element tjetër që do të shtojë, në veçanti, sa i takon
3 kriterit të rëndësisë së materialitetit, pra, faktit në qoftë se
4 bëhet fjalë për një proces me dy faza apo në qoftë se e
5 konsideroni këtë proces si një proces me një fazë.

6 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit, i
7 nderuar Gjykatës. Faleminderit që ratë dakord që ta organizoni
8 këtë seancë gjatë pasdites i nderuar Gjykatës, e vlerësoj shumë
9 këtë gjë.

10 Gjëja e parë që do të doja të theksoja është se Mbrojtja për
11 z. Haradinaj është bashkuar me Mbrojtjen e z. Gucati në
12 parashtrimet me shkrim dhe ne kemi të njëjtën qasje sot, dhe
13 pozicioni i përbashkët i të dy Mbrojtjeve është i njëjtë për këtë
14 çështje.

15 Pra, këto janë çështje të cilat janë të njohura si për ZPS-së
16 ashtu edhe për Gjykatën sepse ka disa kohë që kemi dorëzuar me
17 shkrim këto parashtrime, kështu që nuk dua që të përsëris edhe
18 njëherë ato çfarë i kemi dhënë me shkrim dhe nuk dua të përsëris
19 gjëra të cilat u cekën pak më parë nga Mbrojtja e z. Gucati.

20 Ajo çfarë do të them unë është se pjesa e përgjigjeve të ZPS-
21 së lidhet me një kërkesë pra, kërkesën për të dhëna të cilat ne ia
22 kemi parashtruar Prokurorisë mbi bazën e hetimeve tona pra, mbi
23 bazën e hetimeve të Mbrojtjen, që na tregon apo na demonstroi që
24 është bërë shumë pak sa i takon hetimeve, dhe kjo në vetvete do të
25 përbëjë disa vështirësi.

26 Pra, ne do të donim që Prokuroria t'i përgjigjej këtyre

1 çështjeve, por do të donim që të shikonim gjithashtu edhe nxjerrje
2 të cilat janë realizuar gjatë ditëve të fundit. Padyshim ka disa
3 shqetësime që lidhen me pozicionin e ZPS-së sa i takon
4 interpretimit të rregullës 102(3) pra, që Mbrojtja duhet të bëjë
5 kërkesën e vet dhe sipas ZPS-së nuk përmbushet kriteri i rëndësisë
6 materiale.

7 Pra, këto janë shqetësimet kryesore të miat dhe, siç e thashë
8 më sipër, jam plotësisht dakord me parashtrimet e bëra nga kolegu
9 im, nga Mbrojtja -- nga avokati mbrojtës Rees. Pra, pozicioni ynë
10 është i përbashkët sa i takon këtij elementi, dhe ne duhet që të
11 vazhdojmë që të shprehim shqetësimet tona në të ardhmen lidhur me
12 mënyrën sesi ZPS-ja po sillet lidhur me atë se çfarë beson ZPS-ja
13 që janë detyrimet e veta dhe që nuk po respektohen vendimet e
14 marra prej jush, i nderuar Gjykatës.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

16 Tani le t'ia jap fjalën dhe njëherë Prokurorisë. Nuk e di
17 Prokuroria në qoftë se mund të shtjellojë më tej lidhur me
18 komentet e z. Rees për testin për rëndësinë materiale, apo
19 kriterin e rëndësisë materiale. Do të doja të na jepnit më shumë
20 detaje lidhur me interpretimin e rregullës 102(3) dhe nenit 21(6).

21 Në veçanti, do të doja t'ju pyesja në qoftë juve shihni
22 detyrimin që të ofroni njoftim në një proces prej dy fazash siç u
23 tha nga z. Rees? Pra, së pari që të identifikoni listën dhe pastaj
24 të vijoni më tej me përgjigjen që bëhet nga pala e Mbrojtjes duke
25 përdorur kriterin e materialitetit në këtë pikë, apo d.m.th., si e
26 kuptoni këtë rregull, si e kuptoni rregullën 102(3), si një

1 rregull që përfshin dy faza apo si një rregull që përfshin vetëm
2 një fazë ku ju thjesht bëni njoftimin mbi bazën e një liste të
3 vetme?

4 Ndërsa përpara se t'ia fjalën ZPS-së, do të doja t'i jepja
5 fjalën dhe njëherë z. Rees shumë shpejt dhe pastaj ia japim fjalën
6 ZPS-së.

7 Z. Rees.

8 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar Gjykatës,
9 do të doja t'ju thosha që nuk është parashtrimi im që bën
10 interpretimin e këtij procesi me dy faza, por thjesht do të doja
11 t'ju kujtoja që edhe vendimi i marrë në Vendimin Kuadër është bërë
12 i njëjtë interpretim si interpretimi që dhashë unë.

13 Pra, në paragrafët 46 dhe 48 të Vendimit Kornizë thuhet që
14 duhet që ZPS-ja të japë materialet që ka në dispozicion deri më 19
15 shkurt 2021, mbi bazën e Vendimit Kornizë. Ndërkohë thuhet që
16 duhet që të jepet një njoftim i detajuar sa i takon nxjerrjes ose
17 inspektimit.

18 D.m.th., është një gjë e cila është e përcaktuar në Vendimin
19 Kuadër që keni dhënë ju i nderuar Gjykatës. Është një interpretim
20 me të cilin unë jam plotësisht dakord dhe është pjesë e
21 vendimmarrjes së marrë prej jush, i nderuar Gjykatës.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jam i lumtur që jeni dakord me
23 vendimin tim z. Rees, megjithatë, dua t'ia jap fjalën ZPS-së në
24 qoftë se ata bien dakord me këtë apo jo. Dhe gjëja kryesore tani
25 është pikëpamja e ZPS-së lidhur me këto dy hapa d.m.th., proces i
26 përbërë nga dy hapa apo nga një hap.

1 Z. Prokuror, fjala për ju.

2 Z. PACE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do të doja të filloja
3 duke thënë diçka që e kam thënë edhe më parë, që çështja kundër të
4 akuzuarit është e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë.

5 ZPS-ja i plotëson tërësisht detyrimet sa i takon nxjerrjes.
6 Informacioni përkatës i është vënë në dispozicion Mbrojtjes për
7 një kohë të gjatë tashmë. Mbrojtja është mundur që ta shmangë, ta
8 devijojë Gjykatën duke u mundur që t'i referohet rregullave dhe
9 ligjeve dhe mungesës së bazës së nxjerrjes.

10 Pra, unë do të doja t'ju kërkoja që në qoftë se ka ndonjë
11 element d.m.th., ju keni thënë që ju mund të merrnit kërkesën nga
12 Mbrojtja dhe ne kemi marrë një kërkesë në fakt sipas afatit kohor
13 të përcaktuar në urdhrin tuaj që ishte data 5 mars, dhe i jemi
14 përgjigjur kësaj kërkesë. Më pas kemi marrë një tjetër kërkesë, të
15 cilës po ashtu i jemi përgjigjur.

16 Nga Mbrojtja e z. Gucati na thuhet që jo të gjitha materialet
17 edhe provat duhet -- pra, të gjitha materialet dhe provat duhet të
18 jenë pjesë e kësaj liste. Dhe do të doja të thosha dhe njëherë që
19 kjo nuk përbën një detyrim për ZPS-së dhe nuk është asnjë zgjidhje
20 e pranuar.

21 Nuk jam i sigurt se cili informacion kërkohet dhe nuk e di se
22 çfarë informacioni për çështje të tjera mund të shërbejë për të
23 zgjidhur këtë ngërç momental me Mbrojtjen. I kuptojmë detyrimet e
24 nxjerrjen, nuk do të doja që të përsërisja edhe njëherë atë çfarë
25 thashë më parë sepse detajimet janë dhënë në parashtrimet tona.

26 Pra, dua të them që ne e kuptojmë që bëhet fjalë për një

1 proces me dy hapa. Juve, i nderuar Gjykatës, na thatë që të
2 listonim materialet dhe pastaj të bënim nxjerrjen e tyre, këtë e
3 kuptojmë plotësisht. Pra, e kuptojmë gjithashtu edhe fushën e
4 veprimit si fushë të gjerë, edhe besoj që kësaj i shërben edhe
5 shpjegimi që unë dhashë më sipër. Ne e kuptojmë që megjithëse ju i
6 keni thënë ZPS-së që duhet që të jepni materialet në listë, në të
7 dyja rastet kur kemi materialet ne nuk është se kemi marrë asnjë
8 koment tjetër nga Mbrojtja, dhe interpretimi ynë ishte që ne ishim
9 në rregull me nxjerrjen e materialeve mbi bazën e kërkesës së
10 Mbrojtjes.

11 Gjithmonë Mbrojtja ka thënë që lista nuk është shteruese,
12 ndërkohë që ne mendojmë që Mbrojtja e interpreton këtë listë në
13 mënyrë shumë të gjerë si arsye për të gjetur, nuk e di se çfarë i
14 nderuar Gjykatës. Kjo nuk duhet të lejohet sipas nesh, sepse ne
15 mendojmë që proceset gjyqësore duhet të jenë të fokusuara, duhet
16 të jenë të përqendruara, dhe e kemi dhënë shpjegimin tonë sepse ne
17 kemi qëndrimin që kemi lidhur me rregulloren -- me rregullën
18 102(3).

19 Pra, do t'ju jap dhe një shembull tjetër. ZPS-ja më përpara
20 ka marrë fragmente të dokumenteve nga pjesë të tjera të
21 informacionit që kemi në dispozicion dhe i kemi bërë në
22 dispozicion të Mbrojtjes në një format tjetër, dhe këtë e kemi
23 bërë në frymën e bashkëpunimit për mbrojtje, dhe na është kërkuar
24 më vonë që të japim -- të jepnim dokumentet origjinale të cilat në
25 fakt i kemi zbuluar më pas.

26 Megjithatë, kjo është arsyeja që pse ekziston një dallim

1 ndërmjet listës së dokumenteve që kemi tek lista e nxjerrjes që i
2 kemi dhënë Mbrojtjes. Dhe kjo është për të thënë që ne jemi mundur
3 që të japim informacione të cilat Mbrojtja duhet t'i ketë në
4 dispozicion. Dhe ju jemi drejtuar juve, i nderuar Gjykatës, në
5 momentin kur kemi pasur probleme lidhur me nxjerrjen e
6 materialeve.

7 Më lejoni të shtjelloj po ashtu çështjen që Mbrojtja e
8 Haradinajt tha që është bërë shumë pak sa i takon hetimeve. Dua ta
9 cek këtë element, dhe këtu përfshihet gjithashtu edhe --
10 përfshihen parashtrimet që kanë të bëjmë me Konferencën për
11 Ecurinë e Çështjes që po organizohet sot. Këto parashtrime të
12 cilat mbështeten në pyetjet që ia drejtuar Mbrojtjes së
13 Haradinajt, në vetvete nuk janë -- janë thjesht përpjekje të
14 Mbrojtjes për ta bërë këtë proces gjyqësor në një proces që në
15 fakt ai nuk është.

16 Ne kemi marrë në fakt 39 kërkesa që kanë të bëjnë me
17 identifikimin e personit që i ka lënë dokumentet në Shoqatën e
18 Veteranëve të UÇK-së. E kemi nxjerrë, dhe siç e kemi thënë dhe më
19 parë, pra, kemi nxjerrë informacion lidhur me hapat e ndërmarrë sa
20 i takon zbulimit të identitetit të personit, në veçanti bëhet
21 fjalë për një intervistë të cilën ne ia kemi bërë të ditur
22 Mbrojtjes.

23 Nuk e di se çfarë duan të nxjerrin Mbrojtja në qoftë se do të
24 marrë për shembull, orë të tëra regjistrimesh nga kamerat e
25 rrugëve, dhe në qoftë se do t'i mbikëqyrin dhe do t'i shohin edhe
26 njëherë këto regjistrime. Por akuzat specifike, në fakt, kanë të

1 bëjnë me atë çfarë ka ndodhur pas marrjes së informacionit dhe
2 shpërndarjen e informacionit. Kështu që në këtë kuptim ZPS-ja
3 është shprehur shpeshherë, dhe dua ta them edhe njëherë tjetër që
4 ZPS-ja nuk ka qenë fare e përfshirë në këtë proces dhe nuk është
5 se ka pasur asnjë lloj ndërhyrje tonën. Kështu që përveç këtij
6 shpjegimi që unë sapo dhashë i nderuar Gjykatës, nuk di se çfarë
7 të them tjetër.

8 Këto janë parashtrimet e mia për momentin, megjithatë, në
9 qoftë se keni pyetje ju lutem ndërhyuni i nderuar Gjykatës.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, sa i
11 takon kriterit të rëndësisë materiale, a është i njëjti test që
12 juve përdorni për rregullën 102(3); dhe mendoni që ky është -- i
13 njëjti rregull duhet që të përdoret dhe nga Mbrojtja, apo të
14 përdoret një kriter tjetër siç u nënkuptua nga Mbrojtja, nga z.
15 Rees?

16 Z. PACE: [Përkthim] Testi që mundohet që të prezantojë
17 Prokuroria -- që mundohet që të prezantojë Mbrojtja shkon përtej
18 asaj çfarë na kërkohet neve, pra, neve nuk ka kërkohet që ne të
19 kemi një proces prej dy hapash. Dhe ne mund të themi dhe njëherë
20 që ne e kemi bërë listimin, njoftimin e listave të materialeve
21 përkatëse mbi bazën e rregullës 102(3) edhe nenit 21(6), gjë e
22 cila është në përputhje edhe me Vendimin Kornizë të marrë prej
23 jush i nderuar Gjykatës.

24 Pra, detyra jonë është që ne të bëjmë reflektimin e këtyre
25 materialeve, ndërkohë që Mbrojtja kërkon se çfarë materialesh
26 kërkon më specifikisht. D.m.th., dhe në këtë rast nuk mendoj që --

1 nuk ka argumente që të bëhet fjalë prej një proces prej dy hapash.
2 Pra, dallimi ndërmjet palëve është qartë se Mbrojtja kërkon një
3 listë fillestare që nuk i nënshtrohet asnjë lloj parametri të
4 mundshëm.

5 E kemi dëgjuar dhe sot, e kemi dëgjuar dhe më parë që bëhet
6 fjalë për materiale dhe prova të cilat janë në posedim të ZPS-së,
7 ndërkohë që nuk ka asnjë bazë për një gjë të tillë. Si e thashë,
8 në qoftë se do të ishte kështu proceset gjyqësore do të ishin të
9 pafundme, do të kishte qindra kërkesa për masa mbrojtëse, ose le
10 të themi, argumente dhe kundërshtime për kriterin e rëndësisë
11 materiale.

12 Pra, do të doja të thosha edhe njëherë i nderuar Gjykatës që
13 e kemi bërë interpretimin e gjerë të kësaj kërkesë, e kemi bërë
14 interpretimin e detyrimeve, kemi bërë listimin e materialeve, dhe
15 në qoftë se Mbrojtja donte të kishte dhe material specifik nga
16 lista mund të na drejtohej sërish dhe ne sigurisht që mund t'ia
17 vinim në dispozicion.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

19 Z. Rees.

20 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit.

21 Në qoftë se më lejoni i nderuar Gjykatës, do të doja që t'i
22 referohesha përfundimeve të parashtrimit tim, dokumentin që mban
23 kodin F00157, sepse z. Pace në mënyrë të pasaktë ka sugjeruar që
24 ne kemi propozuar një test për fazën e parë për përpilimin e
25 rregullës 102(3), për njoftimin pra, që kërkohet mbështetur në
26 rregullën 102(3) që nuk ka kufij.

1 Së pari, ZPS-ja e ka Vendim Kornizë tuajin, i nderuar
2 Gjykatës, dhe në këtë vendim përdoret i njëjti formulim siç
3 parashikohet në rregullën 102(3) sa i takon fushës së veprimit të
4 njoftimit. Këto nuk janë fjalët e mia por, siç thoni ju i nderuar
5 Gjykatës, këto rregulla i kërkojnë ZPS-së që të japë njoftim të
6 detajuar, të hollësishëm të rregullës 102(3), të të gjitha
7 materialeve dhe provave në posedim të Prokurorisë. D.m.th., këto
8 janë fjalët tuaja i nderuar Gjykatës.

9 Po ashtu, në të njëjtin vendim, i nderuar Gjykatës, juve keni
10 parashtruar se çfarë duhet që të përfshihet në një formulim të
11 tillë, dhe se në të duhet që të përshiheshin informacione të
12 mbetura potencialisht të rëndësishme për Mbrojtjen. Pra, testi apo
13 kriteri i rëndësisë materiale duhet që të bëhet për të kërkuar
14 nxjerrjen ose inspektimin e materialeve nga lista. Dhe lista në
15 vetvete, sipas vendimit tuaj i nderuar zoti Gjykatës, duhet që të
16 bëhet duke bërë një testim të ndryshëm, më të gjerë d.m.th.,
17 informacionin që ka mundësi që të jetë i rëndësishëm.

18 Në parashtrimet e depozituara në kuadër të F00157-ës, neve e
19 kemi ndihmuar më tej Prokurorinë sa i takon shpjegimit të asaj
20 çfarë nënkuptohet me material relevant apo të rëndësishëm, dhe
21 jemi shprehur që duhet të përfshihen të gjitha materialet të cilat
22 kanë lidhje me një vepër që është nën hetim, ose person që është
23 nën hetim, ose që është në rrethana të caktuara i lidhur me
24 çështjen.

25 Ky në vetvete nuk është një testim pa kufi, por është një
26 test i cili -- absolutisht i shpjegueshëm dhe që bëhet d.m.th.,

1 është një test i cili duhet të lehtësojë hetimet sepse edhe ZPS-ja
2 duhet të jetë në dijeni të faktit se çfarë materialesh kanë edhe
3 që mund të kenë ndikim mbi veprime të caktuara, mbi persona të
4 caktuar, ose në rrethana rrethuese të çështjes në fjalë.

5 Jam i lumtur që Prokuroria më në fund e kupton që bëhet fjalë
6 për një qasje prej dy fazash kur flasim për rregullën 102(3). ZPS-
7 ja nuk ka përcaktuar se çfarë testesh ka zbatuar vetë në mënyrë që
8 të prodhohet faza e parë, të realizohet faza e parë d.m.th., me
9 fjalë të tjera, se cilat janë materialet të cilat duhet të bien
10 nën fushën e veprimit të rregullës 102(3).

11 Siç e thashë dhe më sipër, i nderuar zoti Gjykatës, juve keni
12 marrë një vendim për fushën e veprimit të këtij njoftimi. Ne kemi
13 dhënë parashtrime të tjera shtesë që përmes të cilave pretendonim
14 që ZPS-ja të qartësohej për përmbushjen e detyrimit të saj.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

16 Z. Cadman.

17 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar
18 Gjykatës, nuk kam ndonjë gjë shumë të madhe që dua të shtoj. Besoj
19 që u thanë të gjitha nga z. Rees.

20 Sërish, më lejoni të them që ne nuk po kërkojmë materiale që
21 kanë të bëjnë me çështje të tjera që janë nën gjykim. Do të ishte
22 jo e zgjuar nga ana jonë që të mos dyshonim që ZPS-ja nuk ka
23 çështje të tjera në shqyrtim e sipër, por ne po kërkojmë material
24 që ka të bëjë vetëm me çështjen ku jemi pra, me çështjen që
25 përfaqësojmë. Vetëm kaq doja të shtoja për momentin.

26 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

1 Z. Prokuror, a keni ndonjë gjë për të shtuar lidhur me këtë
2 gjë?

3 Mirë. Atëherë, përpara sesa të përfundojmë me çështjen e
4 nxjerrjes së materialeve, do të doja t'ju kërkoja se cilat janë
5 rezultatet e diskutimeve *inter partes*? Pra, e kuptoj që disa prej
6 problemeve janë zgjidhur sepse ka disa dokumente të cilat janë
7 nxjerrë gjatë javës ose javëve të mëparshme.

8 Do të doja t'ju kërkoja në qoftë se ka më hapësirë për
9 diskutime ndërmjet palëve, apo ekziston nevoja urgjente për të
10 gjetur një zgjidhje për çështjen që sapo ngritëm në mënyrë që të
11 mund të përfundojmë procesin e nxjerrjes së informacionit?

12 Z. Prokuror.

13 Z. PACE: [Përkthim] Po. Siç e thamë, neve u përgjigjëm
14 Mbrojtjes. Mbrojtja nuk është se na u përgjigj -- nuk është se u
15 kundërpërgjigj sa i takon pjesëve të caktuara të përgjigjes tonë
16 dhe në qoftë se ata do të donin që të kishin shpjegime të tjera.
17 Në qoftë se duan që të diskutojnë me neve *inter partes* ose përmes
18 jush, ne pa diskutim që jemi të gatshëm që t'i përgjigjemi. Nuk
19 është fare problem për ne kjo gjë.

20 Kjo ka të bëjë me të dyja kërkesat e Mbrojtjes. Pra, e para
21 është Mbrojtja e z. Gucati dhe që na keni informuar, i nderuar
22 Gjykatës, përmes shtojcës për sa i takon bërjes së parashtimeve
23 për Konferencën e Ecurisë së Çështjes, pra, thjesht na u bënë
24 pyetje për Prokurorinë të cilat neve i interpretojmë në qoftë se
25 materialet e caktuara janë apo jo në posedimin tonë. Ne i jemi
26 përgjigjur Mbrojtjes lidhur me këtë dhe nuk është se kemi dëgjuar

1 më prej Mbrojtjes.

2 Një tjetër gjë që i ndan palët në këtë rast është që ne kemi
3 thënë qartë dhe disa herë që në krijimin e listës, ne e njohim
4 mirë se cilat janë detyrimet tonë mbështetur në rregullën 102(3)
5 dhe në paragrafët përkatës të Vendimit Kornizë që është nxjerrë
6 nga ju i nderuar Gjykatës. Pra, kjo është baza mbi të cilën ne e
7 kemi krijuar, e kemi gjeneruar këtë listë. Dhe do të duam t'ju
8 kujtojmë po ashtu edhe për parashtrimet që ka nxjerrjet që
9 kërkohen nga rregulla të tjera dhe sigurisht, d.m.th., ndikimet e
10 një rregulle mbi tjetrën do të çonin në shkurtimin e listës.

11 Atëherë, e kuptoj z. Gjykatës që ju keni përcaktuar datën 15
12 mars si afatin kohor për Mbrojtjen për të kërkuar material tjetër
13 shtesë, por nuk duket sikur Mbrojtja e ka përdorur këtë mundësi,
14 nuk është se na ka kërkuar që ne të prodhojmë një listë të re
15 brenda këtij afati kohor. Kjo nuk do të na çojë shumë larg. Në
16 qoftë se ka kategori ose zëra të tjerë, materiale të tjera që do
17 të donte Prokuroria [sipas përkthimit], ne jemi të gatshëm që t'i
18 përgjigjemi atyre.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

20 Z. Rees, në lidhje me diskutimet midis palëve.

21 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ne i jemi mirënjohës
22 Prokurorisë që na ka dhënë përgjigje për disa nga kërkesat tona. E
23 pranojmë këtë dhe, siç e thashë, i jemi mirënjohës.

24 Ne jemi dakord me vlerësimin tuaj, i nderuar Gjykatës, që në
25 këtë fazë është shumë urgjente dhe e rëndësishme që Prokuroria të
26 ketë një qasje shumë të qartë që ta zbatojë në lidhje me listën

1 dhe me njoftimin në bazën e rregullës 102(3).

2 Siç tha z. Pace, një numër materialesh apo kategorish të
3 materialeve duhet të na jepen në bazë të njoftimit -- në bazë të
4 rregullës 102(3). Dhe ashtu siç e përmendi z. Pace, këto janë
5 kategori shumë të rëndësishme, janë përmendur si "kategoria A" apo
6 "kërkesa A" dhe "kategoria B" apo "kërkesa B." Këto janë kategori
7 shumë të rëndësishme materialesh. Ne iu përgjigjëm këtyre
8 kërkesave dhe ende s'është marrë vendim për to.

9 Siç e tha z. Pace, ne kemi bërë sugjerime për llojet e
10 kategorive dhe materialeve që duam të përfshihen në atë listë. Dhe
11 e thamë të qartë që kjo nuk është listë shteruese, sepse duke pas
12 parasysh rregullën 102(3) dhe përgjegjësitë e Prokurorisë në
13 lidhje me këtë rregull, në lidhje me materialet që ka në zotërimin
14 e vet, ata e dinë se çfarë kanë, ata e dinë se çfarë përmbajnë
15 materialet e tyre dhe Mbrojtja nuk e di se çfarë kanë ata në
16 zotërim, dhe ne nuk mund ta marrin përgjegjësinë e tyre për të
17 thënë se çfarë materiali është i rëndësishëm pa e parë se çfarë
18 materialesh ka. Pra, dhe në qoftë se ata nuk i fusin materialet në
19 listë duke zbatuar, sipas pikëpamjes së tyre, kriterin e rëndësisë
20 materiale, kjo do të thotë që ata nuk i përmbushin detyrimet e
21 tyre në bazë të rregullës 102(3).

22 Dhe ne mendojmë që ky njoftim në bazë të rregullës 102(3)
23 është një element shumë i rëndësishëm, gur themeltar që nuk mund
24 të anashkalohej nga Prokuroria, dhe pastaj -- dhe Prokuroria po
25 kërkon që të na kalojë direkt te faza e dytë që keni përmendur ju.
26 Ky gur themeltar që është njoftimi në bazë të rregullës 102(3),

1 duhet të na jepet menjëherë në mënyrë që ne të -- të fillohet
2 dorëzimi dhe nxjerrja e materiale në bazë të urdhrit që keni dhënë
3 ju, i nderuar Gjykatës.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Rees.

5 Z. Cadman, keni diçka për të shtuar në lidhje me diskutimet
6 ndërmjet palëve, dhe nuk e di a keni ndonjë shpresë që gjërat do
7 të përmirësohen përpara sesa të jap unë vendimet e mia në lidhje
8 me kërkesën e Prokurorisë?

9 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë them që
10 pozicioni i parashtruar nga z. Rees është pozicioni i saktë dhe i
11 drejtë. Dhe unë dua të them që po, gjërat mund të ecin përpara, po
12 duhet që Prokuroria të ndryshojë komplet qasjen e saj.

13 Dhe duke përmendur që kërkesat e Mbrojtjes janë thjesht
14 metoda për t'i anashkaluar çështjes dhe ajo, nënqeshja apo
15 buzëqeshjet e tyre kur dëgjojnë kërkesat tona, edhe kjo nuk
16 ndihmon në marrëdhënien midis nesh. Ne, sigurisht, duam të punojmë
17 në mënyrë të arsyeshme dhe të bëjmë diskutime të arsyeshme me
18 Mbrojtjen [sipas përkthimit], por duhet të ketë një ndryshim
19 thelbësor në qëndrimin e tyre në mënyrë që të kemi bashkëpunim.

20 Dhe diçka tjetër për të cilën kërkoj unë ndërhyrjen tuaj i
21 nderuar Gjykatës, është qasja te klientët tanë. Sigurisht, ne tani
22 kemi vështirësi në marrjen e udhëzimeve të tyre dhe materialeve
23 sepse të gjitha këto bisedat që bëjmë me ta bëhen me një xham
24 ndarës në mes, dhe duke pasur edhe kohë shumë të kufizuar, është
25 pothuaj e pamundur që të kemi diskutime domethënëse me klientët
26 tanë.

1 Kjo do të kërkojë një ndërhyrje nga Gjykata që të bisedojë
2 dhe -- të bisedojë me njësinë e paraburgimit, sepse në vizitën e
3 fundit që i bëra z. Haradinaj herën e fundit, unë për shembull,
4 nuk mund t'i jepja atij dokumente përtej xhamit. Dhe nuk është
5 mënyrë kjo për të vazhduar punën me klientët tanë.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Zonja Sekretare, unë dua që ju
7 ta njoftoni Administratoren në lidhje me këtë kërkesë që bëri z.
8 Cadman dhe të angazhoheni, të diskutoni me të se çfarë mund të
9 jetë mënyra më e mirë për ta zgjidhur këtë problem për komunikimin
10 e tyre me klientët.

11 Keni diçka tjetër për të shtuar në lidhje me nxjerrjen?

12 Z. PACE: [Përkthim] Shumë shkurtimisht zoti -- i nderuar
13 Gjykatës.

14 Në qoftë se ju, i nderuar Gjykatës, doni të shikoni sesa me
15 seriozitet i kemi marrë ne kërkesat e Mbrojtjes, ne mund të
16 dorëzojmë edhe përgjigjet që i kemi dhënë ne atyre. Ne -- nuk e di
17 se çfarë përmendi në lidhje me buzëqeshjet apo nënqeshjet, apo pse
18 ishin të irrituar, por ne për shembull, në lidhje me parashtrimet
19 e z. Gucati, ne i kemi marrë ato shumë seriozisht, i kemi kthyer
20 përgjigje shumë seriozisht dhe këto s'janë çështje për t'i marrë
21 lehtë.

22 Dhe, nuk e di, do ta them këtë vetëm që në qoftë se ju, i
23 nderuar Gjykatës, do të ndryshoni parametrat e Vendimit Kornizë në
24 lidhje me rregullën 102(3), Prokuroria nuk ka nevojë që të ketë
25 një vendim tjetër në lidhje përgjegjësitë e veta.

26 Desha të theksoj, që të mos ketë keqkuptim, që vetëm dy

1 çështje kanë mbetur të pazgjidhura dhe për të dyja këto ne i jemi
2 drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
4 Prokuror.

5 Ka Mbrojtja diçka për të thënë?

6 Z. Cadman, mikrofonin ju lutem.

7 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Vetëm një çështje
8 të fundit, që s'kemi pasur mundësi t'i përgjigjemi Prokurorisë.
9 Për ta bërë të qartë se ne kemi ndërmend që t'i përgjigjemi, por
10 ndoshta po diskutoj këtu përpara, se kjo ka të bëjë edhe me faktet
11 e pranuar nga palët, por ne -- kjo ishte dhe pjesë e problemit që
12 kisha që nuk munda të komunikoj me klientin tim.

13 Por ne do të përgjigjemi gjerësisht dhe -- në lidhje me
14 kërkesën që ka bërë Prokuroria, por sidoqoftë kjo do të kërkojë që
15 ne të kemi kontakt të duhur me klientët tanë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Për pikën tjetër në rendin e ditës, në lidhje me hetimet.
18 Desha të vë në dukje që pavarësisht nga vështirësitë e KOVIDIT-19
19 dhe kufizimet e tij, hetimet kanë filluar dhe një nga ekipet ka
20 filluar bile edhe hetimet në Kosovë, ka shkuar në Kosovë. Po
21 kështu një udhëtim tjetër është planifikuar nga i njëjti ekip.

22 Po kështu vë në dukje që Zyra Administrative ka bërë një
23 parashtrim *ex parte* në lidhje me ndihmën dhe asistencën në lidhje
24 me udhëtimin dhe hetimet. Faleminderit.

25 Dhe tani ftoj Mbrojtjen të na japë një përditësim në lidhje
26 me hetimet e veta dhe sa kohë do t'ju duhet -- disa afate kohore

1 në lidhje me përfundimin e tyre.

2 Z. Rees, ju lutem.

3 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Pozicioni ynë është
4 i njëjtë me atë të konferencave të mëparshme.

5 Ju keni përcaktuar kalendarin i nderuar Gjykatës, dhe me
6 kalimin e kohës ne mendojmë që pavarësisht nga kufizimet për shkak
7 të pandemisë, ne do të vazhdojmë të përmbushim detyrimet tona dhe
8 të plotësojmë objektivat dhe t'i përmbahemi kalendarit të
9 përcaktuar.

10 Ne kemi thënë më parë që besojmë që do të jemi gati për
11 gjykim në javën që fillon më 13 gusht e më tutje, dhe besoj që
12 jemi në gjendje t'i përmbahemi atij afati.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Cadman.

15 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Edhe ne jemi në të
16 njëjtin pozicion. Ne mendojmë që kemi disa vështirësi që vazhdojnë
17 në lidhje me zhvillimin e hetimeve.

18 Nuk dua të hyj në diskutime dhe mosmarrëveshje të mëtejshme
19 me Prokurorinë për sa i përket a janë bërë hetimet në mënyrën e
20 duhur apo jo, por ne kemi pasur probleme me disa linja të
21 hetimeve. Megjithatë, mendoj që -- besoj do t'i përmbahemi afateve
22 kohore që janë përcaktuar dhe, ashtu siç tha z. Rees, shpresojmë
23 që të bëjmë hetime të mëtejshme të Mbrojtjes brenda javës së
24 ardhshme apo dhjetë ditëve të ardhshme.

25 Kjo do të jetë për -- është e vërtetë për të dyja ekipet e
26 Mbrojtjes. Por kjo do të varet edhe nga situata dhe si do të

1 ndryshojë situata, sepse për shembull, e gjithë Evropa është
2 vendosur në kodin e kuq për sa i përket pandemisë, dhe ndoshta
3 mund të mos jemi në gjendje të udhëtojmë për t'i kryer këto
4 hetime.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

6 Prokuror, a keni diçka për të shtuar në lidhje me këtë
7 çështje, dhe po kështu edhe në lidhje me dosjen paraprake, nëse ka
8 ndonjë ndryshim në pritshmërinë se kjo dosje do të dorëzohet më 9
9 prill?

10 Z. PACE: [Përkthim] Duke e ditur se cila d.m.th., afatet e
11 përcaktuara në kalendar që ju e keni përcaktuar që t'i dorëzohet
12 dosja panelit, ose Trupit Gjykues më 30 qershor, ne s'kemi për të
13 shtuar në lidhje me këtë.

14 Në lidhje me dosjen paraprake, ne do ta dorëzojmë atë në afat
15 pra, më 9 prill, së bashku me materialet e tjera që keni urdhëruar
16 ju për t'u dorëzuar. Faleminderit.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
18 Prokuror.

19 Tani dua t'i kërkoj palëve të më japin mendimet e tyre në
20 lidhje me Konferencën e ardhshme për Ecurinë e Çështjes.

21 Unë e di që Mbrojtja e z. Haradinaj ka shprehur parapëlqimin
22 për fundin e prillit, ndërsa Mbrojtja e z. Gucati ka thënë 14 ditë
23 mbasi të jetë dhënë njoftimi i ri i detajuar nga Prokuroria në
24 bazën e rregullës 102(3).

25 Nën dritën e kësaj, besoj që do ta planifikoj këtë Konferencë
26 të Ecurinë së Çështjes për në fund të prillit.

1 Keni ndonjë gjë palët?

2 Z. PACE: [Përkthim] Jo. Ne jemi në dispozicion kurdo që ta
3 mendoni ju i nderuar Gjykatës.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Rees.

6 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, nuk kam ndonjë
7 gjë. Jam shumë mirënjohës që në Konferencat e mëparshme për
8 Ecurinë e Çështjes ju keni thënë, i nderuar Gjykatës, dhe na keni
9 -- keni thënë që ne t'i dorëzojmë parashtrimet tona në një datë që
10 është afër datës së seancës, dhe do t'ju isha mirënjohës të
11 njëjtën gjë ta bëni edhe për konferencën e ardhshme pra, të
12 katërtën. Duke pas parasysh se ju, i nderuar Gjykatës, që e
13 menduat -- e mendoni që këtë ta bëjmë nga fundi i prillit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

15 Në lidhje me këtë më duhet pak kohë që t'i shikoj të gjitha
16 përpara -- të gjitha parashtrimet tuaja. Nuk e besoj që mund të
17 jetë 12 orë përpara seancës, por të paktën 48 orë t'i dorëzoni
18 parashtrimet në qoftë se jeni të gjithë dakord.

19 Z. Cadman.

20 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Desha vetëm të
21 them që më 26 dhe 27 prill nuk mund të paraqitem, të gjithë ditët
22 e tjera në fund të prillit jam në dispozicion.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Data 27-të është Dita e Mbretit
24 në Holandë, është pushim, kështu që nuk e besoj të planifikojmë
25 konferencë për atë datë.

26 Urdhrin për Konferencën e ardhshme për Ecurinë e Çështjes do

1 ta merrni më vonë, dhe ftoj palët që të bëjnë parashtrimet me
2 shkrim në qoftë se duan të ngrenë ndonjë çështje të caktuar gjatë
3 konferencës së ardhshme.

4 Në këtë moment desha t'i pyes palët nëse keni ndonjë çështje
5 tjetër që doni të ngrini. Dhe, si gjithmonë, u kujtoj palëve që të
6 njoftojnë paraprakisht nëse ndonjë prej parashtrimeve të tyre do
7 të kërkojë nxjerrjen e materialeve konfidenciale.

8 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam asnjë çështje tjetër për të
9 shtuar.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Rees.

11 Z. REES: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë për të shtuar.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Cadman.

13 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk kam asgjë për
14 të shtuar.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Cadman.

16 Tani do të bëjmë një pushim dhe -- do të bëjmë një pushim
17 prej 30 minutash, dhe kur të kthehemi do të jap urdhra gojorë në
18 lidhje me afatet kohore dhe hapat e tjerë proceduralë.

19 Tani është praktikisht ora 16.00. Do të mblidhemi përsëri në
20 orën 16.30. Faleminderit.

21 --- Pauza fillon në orën 15.58

22 --- Rifillon në orën 16.30

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani do të jap disa urdhra me
24 gojë.

25 Së pari, unë dua të nxjerr këtë urdhër për parashtrimin e
26 versionit publik të redaktuar për dokumentin me kodin F116.

1 Në këtë kuadër, dua të kujtoj që në vendimin tim për sa i
2 takon kërkesave paraprake të Mbrojtjes me kodin F147, urdhëroj
3 Mbrojtjen e z. Haradinaj që të dorëzojë versionin e redaktuar
4 publik të dokumentit me kodin F116 deri më datë 15 mars 2021.
5 Mbrojtja e z. Haradinaj deri tani nuk e ka respektuar këtë urdhër.
6 Në këtë kuadër, dua që të theksoj që në momentin kur përmendet
7 emri i stafit të Dhomave të Specializuara ose të ZPS-së në një
8 transkript publik, në përputhje me nenin 33 të Rregullores së
9 Dosjeve dhe Parashtrimeve, palët do t'i referohen anëtarëve të
10 stafit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së vetëm duke iu
11 drejtuar titujve të tyre funksionalë, me përjashtim të rasteve kur
12 është rreptësisht e nevojshme për proceset dhe duhen që të hiqen
13 të gjithë informacionet të cilat kanë të bëjnë me personat në
14 fjalë në goftë se nuk vendoset ndryshe nga Presidenti dhe nga
15 Gjykatësi.

16 Në këtë kuadër, do të doja që t'i kërkoja Mbrojtjes së z.
17 Haradinaj që të jepte deri më datë 1 prill 2021 një version të
18 redaktuar publik të dokumentit me kodin F116, në përputhje me
19 paragrafin 70.

20 Së dyti, dua të jap urdhrin me gojë për parashtrimet e
21 versionit të redaktuar publik për dokumentin me kodin F134.

22 Urdhëroj Mbrojtjen e z. Gucati që të parashtrojë deri më
23 datën 1 prill 2021 një version të redaktuar të dokumentit me kodin
24 F134 që redakton shënimin numër 4 në fund të faqes së kësaj
25 dosjeje.

26 Së treti, nxjerr urdhrin lidhur me riklasifikimin e dy

1 dosjeve.

2 Urdhëroj Zyrën e Administratores që të riklasifikojë si
3 publike dosjet e mëposhtme konfidenciale: Dosjen F125, datë 15
4 shkurt 2021, dhe dokumentin F126, datë 15 shkurt 2021.

5 Ky është urdhri im i tretë.

6 Së katërti, jap urdhrin me gojë lidhur me kërkesën e ZPS-së
7 sa i takon autorizimit të redaktimeve jostandarde, dosja F155.

8 Në këtë kuadër vërej si më poshtë:

9 Në përputhje me vendimin tim për kontakte me dëshmitarë të
10 caktuar, dosja ose parashtrimi F136, ZPS-ja ka identifikuar të
11 dhëna shtesë, materiale shtesë të një natyre të ngjashme dhe i ka
12 nxjerrë ato më 4 dhe 17 mars 2020 [sipas përkthimit] duke aplikuar
13 redaktimet ekuivalente me ato të cilat janë autorizuar në vendimet
14 e përmendura më sipër; që Mbrojtja nuk i është përgjigjur kërkesës
15 së ZPS-së për autorizim të redaktimeve të zbatuara; dhe pasi është
16 -- janë rishikuar redaktimet e aplikuar, unë konstatoj se ato
17 janë në përputhje me kushtet e parashikuara në paragrafët 29 dhe
18 30 të vendimit të përmendur më lartë.

19 Për këtë arsye i jap ZPS-së lejen për të autorizuar
20 redaktimet jostandarde të zbatuara në përputhje me shtojcën 1 të
21 dosjes F155.

22 Ky është urdhri i katërt dhe i fundit për sot.

23 Kemi ardhur në fund të seancës së ditës së sotme. Dua t'i
24 falënderoj palët për pjesëmarrjen. Dua që të falënderoj po ashtu
25 përkthyesit, stenografët, teknikët audio dhe vizio dhe stafin e
26 sigurisë që ka qenë i pranishëm këtu.

1 Ky është fundi i seancës.

2 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes përfundoi në
3 orën 16.34

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25